



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:046148

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06231902

P.nr.290/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit R.S. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprave penale Kanosja nga neni 181 par.3 e lidhur me par.1 dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1362/20 e datës 19.10.2023, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 30.09.2024, në të cilin ish-in të pranishëm prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla, të dëmtuarit Rr.A., A.M., E.H., S.M., i pandehuri R.S. dhe mbrojtësja sipas detyrës zyrtare av.F.B., më datën 30.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë të njëjtë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: R.S. nga i ati Rr..., e ëma N..., e gjinisë M..., data e lindjes... në komunën e Vushtrrisë, me vendbanim në komunën e Vushtrrisë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e fillore si dhe një vit të shkollës së mesme, punon në Zvicër si mbikëqyrës i pastrimit, i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, edhe më parë i gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.SEPSE: Me datën 29.07.2020, rreth orës 12:00 minuta, në fshatin Samadrexhë në Vushtrri, saktësisht në pronën e tij i pandehuri me dashje i kanos personat zyrtar dhe atë Drejtorin e Drejtorisë së Inspektorëve të komunës së Vushtrrisë Rr.A.n, inspektorët S.M., A.M., E.H. në atë mënyre që të njëjtët kishin shkuar për të vërtetuar se a ishte i pajisur i njëjti me leje ndërtimore për ndërtimin e shtëpisë dhe kur i sheh në pronën e tij i pandehuri iu drejtohet me fjalët “Largonu nga këtu, se nëse nuk largoni do të shkoj te marrë automatikun dhe që të gjithëve do të ju vras” me çka tek të dëmtuarit është krijuar ndjenja e frikës dhe ankthit,

- Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së

II.SEPSE: Me datë datën kohën dhe vendin si në pikën e parë të dispozitivit, i pandehuri me dashje e dëmton pasurinë e personit tjetër, automjetin zyrtar Hunday-Xhip, ngjyrë e bardhë me targa 02Z-20-27, pronë e të dëmtuarës Drejtoria e Inspeksionit të komunës së Vushtrrisë, ashtu që ditën kritike i pandehuri R.S., pas një mosmarrëveshje me inspektorët komunal me një shkop të cilin e kishte në dorë disa here e godet veturën zyrtare duke i shkaktuar dëm material në vlerë prej 600 euro,

- Me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 181 par.3 e lidhur me par.1 dhe 321 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 242, 320, 322, 364, 449, 460 dhe 462 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: R.S.:

I. Për veprën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit me rastin e shpalljes së aktgjykimit i është zëvendësuar në DËNIM ME GJOBË shumën prej dymijë (2000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Për veprën e përshkruar si në pikën II të dispozitivit i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej një mijë e pesëqind (1500) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë dënimet me gjobë, atëherë ky dënimet me gjobë, të njëjtat dënime do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të dëmit të i'a paguaj të dëmtuarës Komuna e Vushtrrisë shumën prej gjashtëqind (600) euro.

Pala e dëmtuar E.H. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka hequr dore nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Palët e dëmtuara Rr.A., A.M. dhe S.M. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej dyqind euro (200€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II II.nr.1362/20 e datës 19.10.2023, kundër të pandehurit R.S. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprave penale Kanosja nga neni 181 par.3 e lidhur me par.1 dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.12.2023, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurorja e shtetit Albana Parduzi të dëmtuarit Rr.A., A.M., E.H., S.M., i pandehuri R.S. dhe mbrojtësja sipas autorizimit av.F.B.. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës iu jepet mundësia e deklarimit rreth fajësisë, e njëjta ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurën se në afat prej 30 ditësh ata mund të paraqesin, kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, si dhe kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

I pandehuri me anë të avokates mbrojtës sipas detyrës zyrtare në afatin e paraparë ligjor me datë 18.01.2024 pranë kësaj gjykata ka parashtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës, të cilën gjykata me aktvendimin e datës 14.02.2024 e ka refuzuar si të pa bazuar.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 30.09.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 320 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri R.S. ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre, i premtun gjykatës që në të ardhmen kjo vepër apo vepra të natyrës tjetër nuk do të përsëriten më dhe njëherit i'u kërkon falje të dëmtuarave.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri për të dy veprat penale që i vihen në barrë, pasi që ky deklarim i tij lidhur me pranimin e fajësisë gjen mbështetje të plotë në të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, e që si te tilla e vërtetojnë përtej dyshimit të bazuar mirë gjendjen faktike si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës. Ndërsa ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë ashtu që nuk është e nevojshme elaborimi i provave, gjykatës i kërkon që me rastin e përcaktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit të këtë parasysht këto rrethana dhe atë si rrethanë rënduese shkallën e lartë të dashjes në veprimet e të pandehurit që kjo rezulton nga vetë rrjedha e ngjarjes që ka ndodhur në ditën kritike, shtuar këtu faktin se vet kanosjen e tij i njëjti e ka bërë në drejtim të palëve të dëmtuara duke përmendur edhe arme, si të tilla këto veprime absorbojnë shkallë të lartë të dashjes

në veprimet e tij, gjykatës i kërkon që në raport me të pandehurin sipas detyrës zyrtare të siguroj edhe një certifikate nga evidencat penale, ashtu që në rast se rezulton se i njëjti ka qenë i dënuar më parë me një aktgjykim të formës së prerë të i merret si rrethanë rënduese, ndërsa si rrethanë lehtësuese dhe atë të vetme në këtë çështje penale është pranimi i fajësisë të bërë nga i pandehuri, ndërsa gjykatës i kërkon në pjesën që kinse i pandehuri është penduar për kryerjen e këtyre veprave penale që sipas bindjes së prokurorit të shtetit i njëjti nuk shpreh pendese për veprimet e tij, duke shtuar që gjykatë të njëjtin ta obligoj për kompensimin e dëmit material, pasi që i pandehuri e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës, andaj edhe duke obliguar që të dëmtuarve – Drejtorisë së Inspeksionit të u kompensoj dëmin e shkaktuar në veturë.

I dëmtuari i I lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri dhe njëherit kërkon kompensim të dëmit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurores së shtetit.

I dëmtuari i II lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri dhe njëherit kërkon kompensim të dëmit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurores së shtetit.

I dëmtuari i III lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri dhe njëherit nuk kërkon kompensim të dëmit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurores së shtetit.

I dëmtuari i IV lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri dhe njëherit kërkon kompensim të dëmit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurores së shtetit.

Avokatja mbrojtëse sipas detyrës zyrtare lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin e saj, i cili është njoftuar me pasojat dhe benefitet e pranimin e fajësisë, i njëjti në mënyrë vullnetare pa kurrfarë imponimi pranon fajësinë për veprat penale si në aktakuzë, duke shprehur keqardhje të thellë dhe premtion para gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të njëjta apo të ngjashme, andaj i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga i njëjti pasi ky pranim gjenë mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi i saj e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat ngarkohet, i propozon gjykatës që me rastin e matjes se llojit dhe të lartësisë se dënimit të e vlerëson si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë të bërë nga i mbrojturi i saj, pasi që i njëjti me pranim të fajësisë i ndihmon gjykatës në vërtetimin e plotë dhe të drejt të gjendjes faktike duke e kursyer edhe nga shpenzimet procedurale, keqardhjen e shfaqur nga i njëjti para gjykatës dhe premtimin e tij se në të ardhmen do jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të bie ndesh me ligjin. Gjithashtu të i vlerësoj edhe rrethanat tjera të që gjenden tek i pandehuri dhe ato personale se i njëjti është familjar, baba i tre fëmijëve dhe në kohën e kryerjes veprës penale e ka humbur një fëmijë dhe që ky rast e ka tronditur shumë dhe siç deklaroi i njëjti ka qenë arsyeja se ka dal nga vetja por prapë nuk e arsyeton vetën se ka bërë kanosjen ndaj personave zyrtarë, gjithashtu i njëjti jeton dhe punon në botën e jashtme përkatësisht në Zvicër ku me punën që realizon atje mban edhe një pjesë të familjes në Kosovë andaj i propozon gjykatës që të i vlerësoj të gjitha rrethanat e lartcekura por edhe ato që i gjen sipas detyrës zyrtare dhe të i shqiptoj një dënim sa me të butë duke i zbatuar

edhe rregullat për zbutje të dënimit, pasi që konsideron se edhe me një dënim sa më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

I pandehur në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të avokates mbrojtëse.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues pas leximit të aktakuzën nga ana e prokurorit të shtetit në pajtim me dispozitat e nenit 320 të KPPK-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit numër të rastit 2020-BD-526, i datës 29.07.2020, raporti i oficerit, i datës 29.07.2020, raporti policor i hetuesit, i datës 29.07.2020 procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin-ankuesit Rr.A., i datës 29.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin-ankuesin A.M., i datës 29.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin-ankuesin E.H., i datës 29.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin-ankuesin S.M., i datës 29.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin R.S., i datës 29.07.2020, lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës, i datës 29.07.2020 dhe fotoalbumi në shtojcë prej 10 fotografive.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprat penale Kanosja nga neni 181 par.3 e lidhur me par.1 dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 181 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Kanosja e kryen “*Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit të personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.*”. Ndërsa në nenin 181 par.3 të KPRK-së është përcaktuar se “*Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*”.

Në nenin 321 par.1 të KPRK-se është përcaktuar se formën themelore të Asgjësimit apo dëmtimit të pasurisë e kryen “*Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 322 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.*”

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprave penale Kanosja nga neni 181 par.3 e lidhur me par.1 dhe veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale për faktin se kjo ka ardhur si rezultat se i njëjti ka humbur një fëmijë dhe kjo ka ndikuar në veprimet e tij, si dhe kërkim faljen e shprehur në raporte me të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, si dhe faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre e cila është vërtetuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykimin P.nr.466/2021 i plotfuqishëm me datë 17.05.2022, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri për veprën penale Sulmi ndaj personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej dymijë (2000) euro i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënimi me gjobë në shumën prej njëmijë e pesëqind (1500) euro gjobë i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi për veprën e lartcekur, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me kompensimin e demit material dhe udhëzimin e palëve së dëmtuar në kontest të rregullt civil, gjykata e ka marrë në bazë tënenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”. Kjo pasi që në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 30.09.2024 palët e dëmtuara Rr.A., A.M. dhe S.M. kanë kërkuar kompensimin

e dëmit lidhur me këtë çështje penale.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore – juridike lidhur me E.H. gjykata e morri në bazë të nenit 460 të KPPK-së ku është përcaktuar se *“Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Kur propozimi tërhiqet, i njëjti propozim nuk mund të paraqitet përsëri, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe.”* Pasi që i dëmtuari E.H. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.290/2022, datë 30.09.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.